



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Prot 17/1

Tiranë, 23.1.2024

Vendim nr. 8. datë 23.1.2024

**Për themelimin e çmimit të veçantë shkencor *Pilika* dhe
zhvillimin e konkursit**

**Në 100-vjetorin e lindjes së akad. Petraq Pilikës, themelues dhe
drejtues historik i së parës katedër të matematikës në Shqipëri;
përfaqësues kryesor i shkollës shqiptare të matematikës, me
emrin e të cilit lidhet hyrja e shkencave kompjuterike në vend;
bashkëthemelues i UT; anëtar i Akademisë së Shkencave që
prej themelimit**

Referuar nenit 7 pika 8 të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave
në Republikën e Shqipërisë* dhe nenit 25 pika 8 të Statutit të saj;

Mbështetur në nenin 10 të rregullores *Për çmimet shkencore që
akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe për mënyrën e
organizimit të konkursve të tyre*;

Me propozim të Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike dhe të
komisionit të përhershëm të matematikë-informatikës, në përputhje
me nenin 11 pika 3 të rregullores sipërcituar (bashkëngjitur);

Nxitur prej vlerësimeve e propozimeve të personaliteteve të shquara të
matematikës dhe të fushave të afërme për rolin e akad. Petraq Pilika si
themelues i shkollës së matematikës dhe bashkëthemelues i shkencave
të informatikës; drejtues historik i katedrës së matematikës së
specialitetit për mbi tri dekada; bashkëthemelues i Universitetit të
Tiranës dhe i Akademisë së Shkencave (propozimet bashkëngjitur);

Në nderim të veprimtarisë studimore e drejtuese të Petraq Pilikës, në 100-vjetorin e lindjes (qershor 2024);

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 23.1.2024, vendosi:

1. Të themelohet çmimi i veçantë shkencor *Pilika*, me qëllim nxitjen dhe vlerësimin e punës shkencore në shkencat e matematikës dhe të informatikës (në shkencat kompjuterike). Çmimi nuk është periodik e akordohet rast pas rasti në kuadër të konferencave ndërkombëtare për këto fusha, ose nga IKM e komisioni i përhershëm i matematikë-informatikës;

2. Çmimi i veçantë *Pilika* jepet për:

- Studiuesin më të suksesshëm të karrierës në matematikë dhe/ose në shkencat kompjuterike (brenda dhe jashtë vendit);

- Punimin më cilësor në këto fusha të realizuar nga studiues shqiptarë deri në moshën 50 vjeç (brenda dhe jashtë vendit);

- Doktoratën më të vlerësuar të studiuesve të rinj shqiptarë, mbrojtur e publikuar gjatë periudhës 2010-2023;

3. Përbërja e jurisë së organizimit e vlerësimit për çmimin e veçantë shkencor *Pilika* si dhe kriteret përcaktohen nga IKM në bashkëpunim me komisionin e përhershëm të matematikë-informatikës; çmimi jepet rast pas rasti dhe kriteret specifike të këtij konkurrimi përcaktohen dhe shpallen nga juria.

4. Për herë të pare ky çmim të jepet në matematikë me rastin e konferencës shkencore që organizohet në nderim të 100-vjetorit të lindjes së akad. Petraq Pilikës;

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: SShNT, sekretari shkencor, IKM dhe Komisioni i përhershëm i matematikë-informatikës;

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJNUSHI

KRYETAR

